FALAS
METRO KS
10.10.2011
metro-ks.com



KFOR-i në pritje të vendimit për heqjen e barrikadave në veri të Kosovës, të vendosura nga serbët që nga data 26 korrik 2011. Gjenerali Erhard Drews paralajmëron se dialogu do të ishte më i mirë për të hequr barrikadat, por nëse kjo nuk funksionon, atëherë mund të pritet edhe ndërhyrja ushtarake…

Foto: Reuters

# Bota po e njeh Kosovën

Nga **Besim Kajtazi**

FUNDI i muajit shtator, përkatësisht 24 shtatori solli në Kosovë mbi 100 mysafirë të huaj të kinematografisë botërore, të cilët erdhën për të marrë pjesë në Festivalin e filimit, të tretin me radhë PriFilmFest. Këtë herë në program ishin 39 filma të metrazhit të ndryshëm, ndërsa pati konkurrues nga shumë shtete të botës si Bosnje e Hercegovina, Mali i Zi, Shqipëria, Maqedonia, Franca, Belgjika, Danimarka, Çekia, Polonia, Rumania, Irani e disa shtete të tjera. PriFilmFesti, tashmë ka marrë veten dhe është një nga manifestimet më të mëdha kulturore me përmasa rajonale e ndërkombëtare. Meritë të veçantë padyshim ka drejtoresha e festivalit Vjosa Berisha, e cila këtë herë flet për gazetën METRO - KS.

Faqe 12 - 13



## Brenda

Imazhi i fuqishëm >FAQE 3
Kosovë >FAQE 4 - 7
60 sekonda >FAQEQ 10
MetroLive >FAQE 12-13
MetroLife >FAQE 16-17
Berreta e John Wayne >FAQE18
Bota >FAQE 21
Biznes dhe financa >FAQE 22
Tech Talk >FAQE 19
Sport >FAQE 30-32

## Impressium

**Botues:** N.SH. "METRO - KS"; **Drejtor:** Astrit **KRASNIQ**; **Kryeredaktor:** Xhavit **KAJTAZI**; **Design:** Kreshnik C. **PUSHKOLLI**. **E-mail:** info@metro-ks.com; marketing@metro-ks.com; **Xhirollogaria:** 1501060001013579 Raiffeisen Bank; **Shtyp: ROTOPRINT, Prishtinë. Tirazhi:** 10.000 kopje. **Gazeta shpërndahet FALAS.**

## METRO

**MOTI** 10.10.2011

| | Prishtinë | Prizren | Mitrovicë | Pejë | Gjakovë | Gjilan | Ferizaj |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| min | 5° | 5° | 4° | -2° | 7° | 4° | 5° |
| max | 10° | 10° | 9° | 9° | 12° | 8° | 10° |

Kosova ende nuk ka hyrë në periudhën e organizimit të riciklimit të letrës. Sa më shpejtë që kjo të ndodhë, edhe përfitimet e ekonomisë sonë do të jenë më të mëdha. Luteni që pas leximit të gazetës Metro - KS ta ruani dhe ta përdorni për riciklim.

## fotolajm



**Rënia e mënjëhershme e temperaturës në Kosovë, solli edhe borën e parë në Prevallë të Sharrit. Bora nisi më 8 tetor dhe mëngjesi gëdhiu me pëlhurë të bardhë, siç shihet edhe në foton e gazetës METRO-KS.** Foto: METRO - KS



## Milionerja e rastësishme

AMERIKANIA ka fituar 25 milionë dollarë pasi që shitësja ia ka shitur tiketin e gabuara të lojës shpërblyese . Kathy Scruggs fitoi 25 milionët marrëmendës papritur kur shitësja gabimisht ia dha tiketin për lojën shpërblyese Powerball në vend të tiketit për lotarinë Maga Millions. E sjellshmja Kathy nuk deshi që të kundërshtoj dhe e mori pa fjalë lotarinë e cila më vonë e bëri atë milionere. Fatlumja 44 vjeçare menjëherë ka premtuar se do t'ia ndërtoj shtëpinë nënës së saj e më pas do të udhëtojë duke iu ndihmuar miqve të cilët kanë probleme financiare.

## Autobusi i "gjithësisë" i sheikut, 7 milionë funte

**Sheiku i pasur ka blerë autobusin futuristic të posa prodhuar i cili udhëtuesve iu siguron komoditet sikur limuzina. Sheiku nga Emiratet e Bashkuara Arabe e ka paguar këtë veturë luksoze që i përngjanë 'batmobilit' për shtatë milionë funte . Por pronari i ri me këtë veturë do të mund të bartë në të njëjtën kohë madje 23 pasagjërë. Përveç kësaj ky superbus luksoz mund të përshkoj 110 kilometra për më pak se 30 minuta. Vetura futuristike është ndërtuar në Holandë. Është e lartë 1,65 kurse e gjatë 15 metra.**



## Lajmi i **fundit**

Në ceremoninë zyrtare të funeralit për Ramiz Alinë,dje në Tiranë, ndonëse ceremonia u organizua nga protokolli i shtetit, asnjë prej përfaqësuesve shteterorë nuk ishte i pranishëm...

Gazeta METRO - KS ruan konfidencialitetin me kompaninë tuaj dhe çdo kontakt i ndërsjellë nuk do të bëhet publik pa lejen tuaj. Po qese pranoni bashkëpunimin mund të na kontaktoni përmes numrit të telefonit dhe e-mail adresës info@metro-ks.com






## Tomas Tranströmeri, fitues i Çmimit Nobel 2011 për letërsi



**Në vitin 1981 suedezi mori çmimin gjerman Petrarca, në vitin 1990 Çmimin e Letërsisë të Këshillit Nordik dhe në vitin 1992 ai mori sërish në Gjermani Çmimin Horst-Bienek**

# Imazhi i fuqishëm

AI ËSHTË një poet lirik nga Suedia - dhe tani fitues i Çmimit Nobel të Letërsisë: Tomas Tranströmer, 80 vjeçari pas disa hemoragjive cerebrale thuajse nuk është në gjendje të flasë. Megjithatë ai ka vazhduar të shkruajë. Në Stokholm shumë vetë besonin që juria e Çmimit Nobel donte t'i kursente 80 vjeçarit Tomas Tranströmer ndërkohë të sëmurë rëndë barrën e emocionit për çmimin më të rëndësishëm të letërsisë në botë. Veç kësaj, prej kohësh ishte e qartë se poeti më i famshëm i Suedisë e ka merituar Çmimin Nobel të letërsisë si pak të tjerë. Tani atë e nderuan me këtë çmim dhe kur u bë i njohur ky fakt, kudo shpërtheu gëzimi. Për përvjetorin e 80-të më 15 prill, qeveria e Suedisë i dhuroi Transströmerit titullin e një profesori. Kolegu i tij shkrimtar, Lars Gustaffson shkroi në gazetën "Dagens Nyheter": "Ai është një personalitet mistik, një poet, i cili ka parë zeron, pikën boshe në qendër, pa të cilën nuk ekziston asgjë." Poezia e tij është e mbushur me imazhe të kthjelleta, thuhet në argumentimin e jurisë. Gazeta më e madhe e Suedisë "Aftonbladet" e quajti Tranströmerin "poet, që e duan të gjithë". "Atje ku të tjerë do të flisnin me 100 fjalë, megjithëse 10 do të mjaftonin, Tranströmeri na jep vetëm një fjalë", shkruan kritiku Henrich Detering në gazetën "Frankfurter Allgemeine Zeitung", kur u botua i përkthyer në gjermanisht vëllimi shumë i hollë me poezi i Tranströmerit "E paditura e madhe", në shtëpinë botuese Hanser. **(DV)**








**London School Of English ofron kurse të disenjuara në mënyrë profesionale me një varg programesh dhe nivelesh, me qasje bashkëkohore të mësimit të gjuhës angleze:**

- **Kurse fillestare dhe të avancuara të gjuhës angleze,**
- **Kurse për gjuhën gjermane, frenge dhe italiane,**
- **Përgatitja për TOFEL test,**
- **Anglisht për mjekësi,**
- **Anglisht për biznes,**
- **Gjuhën shqipe për të huajt,**
- **Mësonjëtore komode të pajisura mirë,**
- **Arsimtarë te kualifikuar dhe me përvojë.**

**ANËTARËSOHU TANI! 20€ NË MUAJ**



**Adresa : Bulevardi Bill Clinton, te "Sante-ja" Tel : Office 038 542 513; Mob : 044 150 938, 044 136 510 E-mail : lse_school@hotmail.com**




Hashim Thaçi dhe Jassem Mohammad al-Khrafi

## Kuvajti premton njohjen e Kosovës

# Hashim Thaçi ka pritur al-Kharafin

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur sot Kryetarin e Asamblesë Nacionale të Kuvajtit, Jassem Mohammad al-Kharafi. Thaçi ka shprehur falënderimet për mbështetjen që i ka dhënë Kosovës dhe besimin në njohjen e shpejtë të shtetit të Kosovës nga ana e Kuvajtit. Ai tha se bashkëpunimi mes dy vendeve do të thellohet dhe se Republika e Kosovës mirëpret investimet ekonomike të Kuvajtit.

Al-Kharafi ka falënderuar kryeministrin Thaçi për pritjen e përzemërt, duke shtuar se në ditët në vijim pritet të merret vendimi për njohjen e Kosovës. Dje siç është njoftuar al-Kharafi është pritue edhe nga kryetari i Kuvendit të Kosovës Jakup Krasniqi, ndërsa në aeroportin e Prishtinës është takuar edhe me presidenten Atifete Jahjaga.

## Hoxhaj u nis në EBA, Kuvajt e Katar

ME FTESË të ministrave të Punëve të Jashtme të Emirateve të Bashkuara Arabe, Kuvajtit dhe Katarit, Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj u nis sot për një vizitë zyrtare në tri shtetet. Burime zyrtare të MPJ-së kosovare bëjnë të ditur se në takimet e ministrit Hoxhaj me homologët e tij, do të bisedohet për thellimin e bashkëpunimit ekonomik, kulturor dhe arsimor mes vendeve mike, kontributin e tyre për avancimin e mëtejeshëm dhe përmbylljen më shpejt të procesit të njohjes së Republikës së Kosovës.



Enver Hoxhaj ministër i jashtëm i Kosovës



## Sipas Institutit të financave...

# Kosova me shkallë të lartë të papunësisë



Në Kosovë, sipas njohësve, nuk ka pasur ulje të shakllësë së papunësisë

Sipas të dhënave të Institutit të Financave të Kosovës, që u publikuan ditë më parë, thuhet se mbi 43 për qind e kosovarëve janë të papunë. Këto të dhëna, përfaqësuesit e Institutit të Financave i Kosovës (IFK), i bënë gjatë konferencës së dhjetë ndërkombëtare për biznes dhe punësim, me temën: "Ndikimi i rritjes ekonomike dhe inovacioneve në zhvillimin e biznesit, zvogëlimin e papunësisë dhe varfërisë në Kosovë, në vendet në transicion dhe në ato në zhvillim".

Kryetari i këtij instituti, Isak Mustafa, tha se Kosova vazhdon të mbetet vendi me normë më të lartë të papunësisë në rajon.

"Kosova ka mbi 43 për qind të papunë dhe 34 për qind në varfëri, me më pak se 1,42 euro në ditë dhe 18 për qind në varfëri të skajshme me më pak se 94 centë në ditë. Kosova vazhdon të mbetet vendi me normën më të lartë të papunësisë në rajon. Kosova vazhdon të ketë GDP-në jo më të madhe se 4.2 miliardë euro", thekson ai.

Ndryshe, në vitet e fundit në Kosovë, sipas njohësve të çështjeve ekonomike, nuk ka pasur ulje të shkallës së papunësisë.

Ndërkaq, sipas tyre, në tregun e punës në Kosovë hyjnë deri në 35 mijë të rinj, ndërkaq ky treg absorbon nga 4 deri në 6 mijë punëtorë në vit.

## Opozita kundërshton bisedimet politike

Opozita në Kosovë, që vazhdimisht ka kundërshtuar bisedimet teknike Kosovë – Serbi, është kategorikisht kundër idesë për hapjen e një kapitulli të ri, atë të bisedimeve politike. Kundërshtitë e subjekteve politike opozitare të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës vijnë në kohën kur janë shtuar zërat që bëjnë thirrje të tilla, madje ato vazhdojnë t'i kërkojnë qeverisë ndërprerjen e bisedimeve të tanishme teknike. Ndërsa, në partinë e kryeministrit Thaçi, në PDK, deklarojnë se për bisedime politike është vetëm Kuvendi ai që mund të autorizojë qeverinë.



Pamje nga një seancë parlamentare


**Prishtina High School**
A division of American Schools International




Phone: 038-258-358 & 044-901-901
Contact
email:info@prishtinahighschool.org
website:www.prishtinahighschool.org

Prishtina High School is a division of American Schools International, Incorporated in the State of Ohio, Licensed by the Ministry of Education, Science and Technology of Kosovo, and has candidacy status for accreditation with AdvancED/NCA CASI.

American Schools International
A Real Chance For Success

Lokacioni
Lagja e Matit 10000 Prishtinë, Kosovë



## Regjistrimi i popullsisë në Serbi i papranueshëm për shqiptarët




**Belgëzim Kamberi e sheh si të drejtë bojkotin e regjistrimit nga ana e shqiptarëve. Ai vlerëson së ky refuzim nuk do të lejojë që të legjitimohet numri i madh i popullatës se zhvendosur.**

# Shqiptarët bojkotojnë regjistrimin e Serbisë

Shqiptarët e Luginës së Preshevës janë duke e bojkotuar regjistrimin e popullsisë në Serbi. Përfaqësuesit e shqiptarëve theksojnë se ky proces po bojkotohet për shumë arsye, e një nga to, është edhe përpilimi i listave vetëm në gjuhën serbe dhe atë me alfabetin cirilik. “Shqiptarët e Luginës së Preshevës nuk marrin pjesë në procesin e regjistrimit që po zhvillohet në Serbi, për arsye se nuk janë garantuar kushtet për një regjistrimit të drejtë”, ka thënë për “Radio Evropa e Lirë”, kryetari i Komunës së Bujanocit, Shaip Kamberi. Edhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Luginë e Preshevës, që drejtohet nga Belgëzim Kamberi e sheh si të drejtë bojkotin e regjistrimit nga ana e shqiptarëve. Ai vlerëson së ky refuzim nuk do të lejojë që të legjitimohet numri i madh i popullatës se zhvendosur. Zyrtarët e Qeverisë së Serbisë kanë thënë se personat ose familjet të cilat refuzojnë pjesëmarrjen në regjistrim, do të gjobiten sipas ligjit për regjistrim. Dënimet thuhet se do të jenë nga 198 deri 495 euro. Mirëpo, Kamberi nuk beson se një gjë e tillë do të ndodhë.








## Pas vizitës së Cooper-it në Beograd dhe Prishtinë

# 14 tetori, në pikëpyetje



**A do të mbahet takimi i radhës me 14 tetor në Bruksel?**

Pas takimeve jo shumë inkurajuese me palën serbe në Beograd, i dërguari i Bashkimit Evropian për ndërmjetësim në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Robert Cooper, pritet të bisedojë edhe me shefen e delegacionit të Kosovës, Edita Tahiri, në lidhje me vazhdimin e dialogut.

Takimi i radhës ishte paraparë për datën 14 tetor, mirëpo nuk dihet nëse ai do të zhvillohet, për shkak të insistimeve të palës serbe që temë diskutimi të jenë edhe pikat doganore 1 dhe 31 dhe gjendja e krijuar në veri të Kosovës.

Tahiri thotë se qëndrimi i Qeverisë së Kosovës është i qartë, se për këto çështje nuk do të bisedohet.

### Loja e Serbisë me ndërkombëtarët

**Loja e Serbisë më bashkësinë ndërkombëtare po vazhdon, ndërkohë që barrikadat në veriun e Kosovës vetëm sa po shtohen. Barrikadimi i serbëve është kritikuar edhe nga disa zyrtarë të opozitës serbe në Serbi, por edhe ndërkombëtarë dhe është kjo një politikë e pakuptimtë të cilëën po e udhëheq Beogradi ndaj Kosovës, vetëm e vetëm për të shkatuar dhunë...**



“Ne kemi platformën e qartë për këtë dialog, me vijat e kuqe”, ka thënë ajo për “Radio Evropa e Lirë”. Hyrja e Qeverisë së Kosovës në bisedime me Serbinë, ishte bërë pa miratimin e opozitës, e cila nuk e pati votuar rezolutën në Kuvend me të cilën qeveria autorizohej të fillonte negociatat për çështjet teknike.

Shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, thotë se këto bisedime kanë qenë politike nga fillimi dhe se tani vetëm po dëshirohet që ky dialog të ngarkohet edhe me një temë ekskluzive politike, siç është veriu i Kosovës. “Për LDK-në aktualisht nuk duhet të ketë kurrfarë bisedimesh”, ka theksuar Beqiri.

## metroshkurt

### Sa kushton pasaporta biometrike?



PËR marrjen e pasaportës biometrike të Republikës së Kosovës, qytetari duhet të paguajë, shumën si në vijim: Për marrjen e pasaportës për herë të parë, çmimi është 30 euro; për marrjen e pasaportës të humbur, apo dëmtuar, për ndërrim apo ripërtëritje të dhënave, çmimi është 35 euro; për marrjen e pasaportës për fëmijë deri në moshën 3 vjeç, çmimi është 20 euro. Për marrjen e pasaportës për fëmijë prej 3 deri në 18 vjeç, çmimi është 25 euro; për marrjen e pasaportës diplomatike, çmimi është 50 euro; për marrjen e pasaportës zyrtare, çmimi është 35 euro. Çmimi i pasaportës biometrike për pensionistët është 20 euro.

### Azem Vllasi: Beogradi pengon intergrimin

**ISH-FUNKSIONARI i dikurshëm i Kosovës, Azem Vllasi, ka thënë se Serbia më së miri do t'i ndihmojë serbët duke e njohur pavarësinë e Kosovës. Ai ka vlerësuar se pushteti aktual në Serbi është vazhdimësi e politikës së Miloshevicit. “Kjo politikë është absurde dhe tragjikomike. Milosheviqi, i dhunshëm, i ashpër, pa vizion dhe pa urtësi ka menduar se njëmend kështu mund ta mbajë Kosovën në Serbi. Por, përfundoi në Hagë. E tash këta që janë në pushtet në Serbi, kur është fjala te Kosova, as nuk dinë se çka bëjnë e as çka flasin”, ka thënë Vllasi.**

### Serbët e veriut me mendësi të Milloseviqit

Vendosja e barrikadave në veri nga serbët lokalë, konflikti i shëmtuar me KFOR-in dhe reflektimi i ngjarjeve kanë dërguar porosinë se Serbia po përdorë mekanizmat e politikës humbëse të Milloshevqit, ka thënë Rada Trajkoviq, deputete serbe në Kuvendin e Kosovës. “Serbia po përdorë mekanizmat e politikës humbëse të Milloseviqit, e cila në fund rezulton me fatkeqësinë e popullit dhe ndjekjen e tij, si dhe me fushata të mëdha kundër bashkësisë ndërkombëtare që e qojnë vendin në izolim”.






Kuriozitete

# Kërcimi i arinjve të Alaskës



**Fotografia, flet më shumë se teksti. Dy arinj, ne Alaskë vallëzojnë. Lëvizjet e tyre harmonike gjatë kërcimit në ujë janë të veçanta**

Sigurisht, edhe po të kishit rastisur përballë disa të tillëve, do të kishit menduar se po grindeshin me njëri-tjetrin. Por këta arinj të Alaskës janë fotografuar teksa kanë qenë duke kërcyer, një mënyrë argëtimi ndërmjet tyre, që në gjuhën tonë do të përkthehej 'kërcim'. Ndiqni fotografitë për të kuptuar lëvizjet kronologjike të tyre.



## Edhe një zbulim japonez

**Një kompani japoneze ko konstruktuar robotin për larjen e flokëve. Roboti i cili ende nuk është pagëzuar , ka 16 gishtrinjë kurse në te jan future edhe shamponi, masazhisti si dhe uji për shpërlarjen e flokëve. Mjafton vetëm të uleni në karrige, të ngjashme me atë të stomatologut dhe të mbështetni kokën në sistemin e robotit. Larja e flokëve zgjatë tre kurse terja pesë minuta. Ekspertët që e kanë konstruktura theksojnë se nuk ka asnjë dallim ndërmjet gishtërinjëve të njeriut dhe atyre të robotit , dhe se ky mekanizëm është ideal për entet shëndetësore dhe shtëpitë e pleqve. Zbulimi i ri japonez do të gjendet në treg qysh në vitin e ardhshëm.**



# metrokult

## Lotët e qiellit, Te Qafa



Në Galerinë e Ministrisë së Kulturës, në Prishtinë, po qëndron e hapur ekspozita vetjake e piktorit Faton Aliu. 18 piktura në punuara në pëlhurë me teknikën vaj dhe akril, shprehin një botë të veçantë kreative të këtij piktori të ri, i cili hapin e parë të tij tejet serioz e shfaqi para artdashëesve të kryeqytetit me ciklet "Universi", Peisazhet në Univers", "Lotët e qiellit" dhe "Milingonat". "Këto piktura, në shtjellimin e vet, i kanë vuajtjet, dashurinë, por njëherit edhe dhembjen që shpërfaqen përherë me ngjyra melankolike", shprehet kritiku i artit, Bislim Aliu. Ngjyra e gjelbër, e kaltër, e verdhë dhe e kuqe, qartësojnë ndjesinë e lartë të piktorit.

## Më 11 tetor, Xzibit në Prishtinë

**Pas koncerteve të disa muajve më parë, kur u paraqitën Busta Rhymes e Lloyd Banks, edhe një tjetër emër do të vijë në Prishtinë. Më 11 tetor, Xzibit do të këndojë në Prishtinë. Reperi me emrin e plotë Alvin Nathaniel Jonier, ka bërë emër me këngën e tij debutuese "At the Speed of Life". Deri më tash ka botuar shtatë albume. Më i riu, "Restless 2", ka dalë në fillim të tetorit.**

## Martesa e tretë e dukeshës...

Dukesha e Albës, 85-vjeçarja Maria del Rosario Victoria Eugenia Cayetano Alfonso Francisca Fitz-James Stuart de Silva, u martua në Pallatin Duenas në Sevilë për të fejuarin e saj që është 25 vjet më i ri se ajo. Gruaja më e pasur në Spanjë, e cila ka 44 tituj mbretërorë, mbase edhe po kaq operacione plastike, u martua me Alfonso Diez Carabantes, pavarësisht kundërshtimit nga familja. I zgjedhuri i saj ka punuar në shërbimet sociale, ndërsa gjashtë fëmijët e saj janë të bindur se ai dëshiron vetëm pasurinë e dukeshës. Alfonso është burri i saj e tretë. **(AFP)**

# :60

SEKONDA INTERVISTË



**Sekondat e parë të bisedës ":60..." në gazetën "METRO – KS", kësaj radhe jo pa qëllim i kemi rezervuar për botuesin, Astrit Krasniqi. Arsyeja është e qartë. Në tregun e Kosovës, po del për herë të parë një gazetë që për shumëçka është më e veçantë se simotrat e tjera të këtij tregu...**

**Astrit Krasniqi**

**Bisedoi: Xhavit Kajtazi**
60sekonda@metro-ks.com

■ **Prej nga ideja që të nisni këtë projekt?**
"Unë kam jetuar një kohë të gjatë në perëndim. Në fillim më ka joshur për shumëçka. Por, me kohën u binda se ishte një rrugë e gabuar për shumë arsye. Gjatë punës në perëndim e kam ndier veten si një robot. Punë, shtëpi, punë, shtëpi... Në Angli, siç e dini, puna është tërësisht private, dhe njerëzit kërkojnë nga ti më shumë punë se sa që duhet. Ti bën edhe nga 50 orë punë, që punëdhënësi të bindet se meriton të të shpërblejë me shumë. Shkurt, të duhet përvoja, dëshmimi... Pra, po del se mërgimi nuk është zbavitje...
Idenë e gazetës, kam parë në Angli në vitin 1999, kur për herë të parë ka dalë "Metro" dhe më ka lënë shumë përshtypje. Është gazetë e fuqishme sa edhe "Times", që ka dalë më 1892. Fuqia e saj qëndron në tirazh, në shpërndarjen falas, por edhe në cilësinë e saj...
Me këtë ide dua që të nxis rininë e Kosovës të lexojë atë që u pëlqen. Sepse gazetat janë të mira. Rinia, por jo vetëm ajo, duhet të lexojë gazetat. Kjo i bënë më të pasur, sepse informohet, krijojnë vizionin për jetën dhe punën, zbaviten dhe fitojnë shprehi leximi. Gjithmonë në jetën time më ka ndjekur mendimi i shkrimtarit të njohur freng, Victor Hugo, që i parafrazuar tingëllon kështu: "S'ka gjë më të fuqishme se sa ideja e duhur në kohën e duhur".

■ **Cilave mosha u dedikohet gazeta "METRO - KS"?**
"Gazeta "METRO – KS" u dedikohet lexuesve prej moshës 18 – 50 vjeç. Këtë do ta hetojnë lexuesit që nga numri i parë, i cili del sot. I ftoj ta marrin gazetën. Le ta lexojnë... Jam i bindur se nuk do t'i ndahen më gazetës. Do të rriten dhe mplaken së bashku me të përditshmen "METRO - KS". Së bashku edhe me njerëzit që e bëjnë gazetën. Po dua që edhe në Kosovë të përqafohen shembujt e mirë të botës së qytetëruar".

■ **Gazeta do të jepet falas?**
"Falas. Unë mendoj se ka ardhë një kohë që për t'u informuar nuk ke nevojë të paguash. Ka mënyra dhe forma të tjera që mund të mbahen në jetë gazetat. "METRO – KS" do të shpërndahet falas përgjitmonë. do të jetë e stilit evropian. Do të ketë më shumë kulturë, sport, kuriozitete, zbavitje. Edhe politikë. Por, kjo nuk është preokupimi kryesor i gazetës".

■ **Tirazhi?**
"Gazeta "METRO – KS" është e përditshme. Do të del prej të hënës deri të premten. Që në start tirazhi do të jetë i madh. Por flas për kushtet e Kosovës. Fillimisht kemi menduar që ta nxjerrim një herë në javë në 10 mijë kopje. Do të jetë tërësisht me ngjyra, në 32 faqe, me format ekskluziv, dhe cilësi të dorës së parë. Shpërndarja e gazetës do të bëhet nga dora në dorë, që nga e hëna, nëpër qytetet më të mëdha të Kosovës".

**"S'ka gjë më të fuqishme se sa ideja e duhur në kohën e duhur".**



# Ndahen Erioni dhe Bertina



ÇIFTI simpatik i "Big Brother 3", Erion Zeqiraj dhe Bertina Mehmeti, kanë pësuar gjatë kohëve të fundit një krisje në marrëdhënien e tyre, krisje kjo e paparuar ende.
Burime pranë çiftit tregojnë për "Bluetooth" se gjatë gjithë kësaj jave çifti ka qenë i ndarë, ndërkohë që vetëm ditëve të fundit janë takuar për të sqaruar problemet me njëritjetrin, por siç mësohet edhe ky takim nuk ka rezultuar fort i frytshëm. Tashmë marrëdhënia e tyre është mjaft e ndere dhe ndonëse për median nuk e kanë pranuar ndarjen, është e sigurt që kjo ndarje e parë, do të pasohet nga një tjetër pas pak kohësh, e cila ndoshta do të jetë definitive. Çifti simpatik i "BB3", i njohur për dashamirësinë e madhe që ka në publik, i ka surprizuar të gjithë fansat me këtë lajm. Ka qenë Bertina në fakt ajo që ndezur alarmin përmes ndryshimit të statusit nga "in a relationship" në "single", pavarësisht se në një komunikim me gazetën e ka mohuar në mënyrë kategorike ndarjen.

## aforizëm

Shkruaj shkurtimisht, që ata të të lexojnë; qartë, që të të çmojnë; me stil, që të të mbajnë mend; dhe, mbi të gjitha saktë, që të të udhëhiqen nga drita e asaj që ke shkruar.



## fjalë e urtë

**Pushteti i do ata që mbjellin, e jo ata që vjelin...**

## anektotë

### Mbreti, furraxhi!

Një mbret i sapozgjedhur thërret kadiun dhe i thotë:
"Çdo njeri që merrni në pyetje, unë ia jep dënimin!"
Kadiu, i habitur, ia tha mbretit:
"Lartmadhëri, i kemi organet për këtë punë", por mbreti nuk ia vari.
Një ditë zabitët e mbretit kishin arrestuar një njeri në treg, i cili i kishte dhënë një flakaresh një tjetri pas një fjalosjeje. E marrin në pyetje, ndërsa më pas e dërguan te mbreti për t'ia shqiptuar dënimin.
Mbreti pyeti:
"Çka ka bërë ky?"
"I ka rënë shuplakë filanit", ia priti zabiti.
"N'furrë!", dha urdhër mbreti, ndërsa zabiti u shtang pas këtij vendimi, duke i thënë:
"Lartmadhëri! A mbytet njeri për një flakaresh?!"
Një tjetër njeri i kishte vjedhë dy lira. E zunë zabitët dhe e morën në pyetje, ndërsa më pas e dërguan te mbreti për t'ia shqiptuar dënimin.
"Çka ka bërë ky?", pyteti mbreti.
"I ka vjedhur dy lira", ia priti zabiti.
"N'furrë!", dha urdhër mbreti, ndërsa zabiti i tha: "Lartmadhëri! A mbytet njeri për dy lira ?!"
U interesuan për mbretin, se ç'është kjo punë e tij që po thotë: "Shtine njeriun n'furrë". E kuptuan se babain e kishte pasur furraxhi, ndërsa edhe i biri kishte punuar po këtë zeje.
"Njeriu nuk është si buka", u përhap lajmi në popull.

# metrokult

## Genta në Festivalin e Këngës?



Sipas burimeve të Telegrafit.com, këngëtarja energjike Genta Ismajli është në përgatitje të një kënge me të cilën ajo do të marrë pjesë në edicionin e 50-të jubilar të Festivalit të Këngës në RTSH. Edhe pse Genta nuk ka konfirmuar zyrtarisht asgjë deri tani, ne kemi mësuar se ajo është duke bashkëpunuar me një kompozitor më famë ndërkombëtare.

## Rita Ora krenare me Kosovën

**Këngëtarja kosovare me famë botërore, Rita Ora, ka thënë se ajo ndihet krenare që është kosovare, përkundër faktit se jeta e saj dhe karriera janë në Amerikë. Këngëtarja e cila për albumin e ri do të bashkëpunojë me artistë të kategorisë së rëndë si Jay-Z dhe Drake, nuk e harron aq lehtë nga e ka prejardhjen dhe madje ndihet krenare për origjinën e saj.**

## Jackson nderohet me koncert

Në koncertin në nder të Michael Jackson, të zhvilluar në Kardif të Uellsit, kanë qenë të pranishëm edhe fëmijët e mbretit të pop-it, Prince Michael, Paris dhe Blanket. Paris kishte veshur xhaketën e famshme që babai i saj mbante në videoklipin e këngës Thriller. "Jemi të lumtur që jemi bashkuar në këtë mbrëmje për nder të babait tonë", theksoi Paris.



metro **live**

## Vdiq krijuesi i iPhone Steve Jobs

**Bashkëthemeluesi i Apple, Steve Jobs ka ndërruar jetë të mërkurën, në moshën 56 vjeçare pasi nuk mundi ta fitoj luftën me kancerin. Ai pati dhënë dorëheqje nga posti i drejtori ekzekutiv të Apple në gusht të këtij viti. Jobs do të mbahet mend për transformimin e tekonologjisë personale me produktet e jashtëzakonshme të iPod, iPad, iPhone, kompjuterit Macintosh dhe me iTunes për muzikë. "Apple ka humbur një gjeni vizionar dhe kreativ, dhe bota e ka humbur një qenie të mrekullueshme njerëzore. Ne që kemi pasur fatin ta njohim dhe të punojmë me të e kemi humbur një mik të dashur dhe një mentor inspirues. Steve e lë pas një kompani që vetëm ai ka mundur ta ndërtojë, dhe shpirti i tij përgjithmonë do të mbetet themeli i Apple.Brilianca e Steveit, pasioni dhe energjia e tij ishin burimi i inovacioneve pa fund që e pasuruan dhe e përmirësuan jetën e secilit prej nesh. Bota është pamatshëm më e mirë për shkak të Stevit", thuhet në një njoftim të kompanisë së madhe.**



Intervistë : Vjosa Berisha, drejtore e Prifilmfestit 2011 në Prishtinë

# Bota po e njeh Kosovën

Nga **Besim KAJTAZI**

FUNDI i muajit shtator, përkatësisht 24 shtatori solli në Kosovë mbi 100 mysafirë të huaj të kinematografisë botërore, të cilët erdhën për të marrë pjesë në Festivalin e filmit, të tretin me radhë PriFilmFest. Këtë herë në program ishin 39 filma të metrazhit të ndryshëm, ndërsa pati konku rrues nga shumë shtete të botës si Bosnje e Hercegovina, Mali i Zi, Shqipëria, Maqedonia, Franca, Belgjika, Danimarka, Çekia, Polonia, Rumania, Irani e disa shtete të tjera. PriFilmFesti, tashmë ka marrë veten dhe është një nga manifestimet më të mëdha kulturore me përmasa rajonale e ndërkombëtare. Meritë të veçantë padyshim ka drejtoresha e festivalit Vjosa Berisha, e cila këtë herë flet për gazetën METRO - KS.

**1.. Është ky festivali i tretë i i filmit në Kosovë. Çka e dallon këtë vit "PrifilmFestin" nga ai vitit i kaluar?**

E dalluan shume gjerë. Programi është zgjeruar me më shumë seksione, përveç programit garues të filmave të metrazhit të gjatë, edhe filmat e metrazhit të mesem u futën në garë këtë vit dhe kishim edhe shumë mysafirë, PriFilmFORUM në edicionin e vet të dyte si forum i koproduksionit solli shumë ekspertë të kësaj fushe nga Evropa, që diskutuan çështjet e koproduksionit me rajonin dhe me shtetet evropiane, distribuimin e filmit dhe shitjen e tij si dh u rrahën edhe një varg temash tjera të rëndësishme. Në përgjithësi mund të them lirisht se PriFilmFesti po rritet çdo vit, dhe në vitin e vet të tretë, unë besoj se e ka zënë vendin e parë në Kosovë si ngjarje më e rëndësishme kulturore dhe me e madhja për nga volumi dhe organizimi.

**2. Ndër 39 filma që u shfaqën në PrifilmFest, morën pjesë edhe tre filma shqiptar. A do të thotë kjo se kinematografia shqiptare është në krizë?**

Morën pjese tre filma: Falja e gjakut, Amnestia dhe Pazari i Ballkanit. Nuk është aspak në krizë. Tre filma janë një sukses mjaft i madh për Shqipërine në fakt.



**3. Festivali solli në Prishtinë, emra të njohur të kinematografisë botërore. Çka do të thotë kjo për kulturën shqiptare?**

Ardhja e emrave të njohur të kinematografisë botërore në Kosovë është shumë e rëndësishme për kulturën kosovare sepse hap mundësitë e shkëmbimit të përvojave në mes kineastëve tanë dhe atyre të huaj, njohjen, krijimin e miqësive dhe mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen. Kjo kontribuon gjithsesi edhe në zhvillimin e kinematografisë sonë.

**4. Festivali për surprizë pati gjithsesi pjesëmarrjen e nipit të aktorit të madh Aleksandër Mojsiu, aktorin gjerman Gedeon Burkhard. Si ndodhi kjo?**

Shumë thjeshtë. Filmi i tij më i ri konkurroi të jetë në festival në programin e metrazhit të mesëm. Ne e pranuam dhe e ftuam edhe Gedeon Burkhardin të vij, duke i ofruar të jetë president i jurisë ndërkombëtare për filmat e metrazhit të gjatë. Ai e pranoi oferten me shumë kënaqësi dhe u entuziazmua që po vinte për herë të parë në një mjedis shqiptar, pra në Kosovë. Këtu kaloi shumë momente të bukura dhe ne jemi shumë të kënaqur që Gedeon Burkhard u miqesua me PriFilmFest-in.

**5. Mund të presim diçka tejtër nga ju deri në përbyllje të vitit ?**

Po, ne vazhdojme të punojme dhe do t'ju informojme për vizitat tona në festivale tjera që do të organizohen jashtë Kosove...



## Ndërron jetë Ramiz Alia

**Ka ndërruar jetë në orën 7.00 të ditës së premte në sanatoriumin e Tiranës, Ramiz Alia, 86 vjec, ish-Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë dhe ish-Presidenti i parë i Shqipërisë pluraliste.Pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 22 marsit 1992 ku fitoi koalicioni i opozitës i udhëhequr nga Partia Demokratike, më 3 prill 1992 Alia dha dorëheqje nga posti i Presidentit dhe u tërhoq nga jeta aktive politike, ndërkohë që Partia e Punës kishte filluar reformimin, duke u shndërruar në një Parti Socialiste, me në krye Fatos Nanon.**

## Afganistan, vriten 2 ushtarë të ISAG-it

Në jug të Afganistanit kanë humbur jetën 2 ushtarë të ISAF-it (Forcës Ndërkombëtare të NATO-s në Afganistan) pas një sulmi të ndërmarrë nga rebelët. Emrat dhe kombësia e viktimave nuk janë bërë të ditura. Sipas përllogaritjeve jozyrtare, ushtarët e huaj që kanë vdekur në Afganistan gjatë muajit tetor janë 6, ndërsa ata që kanë humbur jetën që nga fillimi i vitit janë 475.

## Martesat e armatosura

KY BURRË që ka pozuar me dy pushkë gjahu përkrah nuses së tij, ka sjellë një kuptim të ri, atë të "dasmës me pushkë". Rebelët tashmë kontrollojnë shumicën e Libisë, ndërkohë që besnikët e tyre kontrollojnë së paku 3 qytete, përfshirë edhe Sirtin. Nuk dihet ende se ku ndodhet Kolonel Gadafi, por për djalin e tij Saadi thuhet se është strehuar në vëndin fqinjë, Nigerinë. Këta rebelë të armatosur, po i japin një kuptim të ri martesës në këtë vënd.



## 101 viktima nga tajfuni

**BILANCI i viktimave nga tajfuni që goditi pjesën veriore të Filipineve duke shkaktuar vërshime të mëdha, ka arritur të dielën në gjithsej 101, njoftoi shërbimi nacional për situata të jashtëzakonshme. Vërshimet e shkaktuara nga tajfuni, të cilët njëri pas tjetrit kanë goditur Filipinet, mund të zgjasin edhe një muaj, kanë bërë të ditur autoritetet. Situata pas goditjes së tajfuneve "Nesat" dhe "Nalga", është rënduar dukshëm nga shiu i cili vazhdon të bie në viset bregdetare në veri të kryeqytetit Manila. Për shkak të vërshimeve dhe rrëshqitjeve në Filipine rreth 590.000 njerëz janë detyruar t'i braktisin shtëpitë e tyre. Pavarësisht kushteve të këqija atmosferike autoritetet kanë dërguar ndihma ne ushqime në rajonet e rrezikuara. Vlerësohet se dëmet e shkaktuara nga moti i lig në këtë shtet aziatik sillen rreth 320 milionë dollarë.**




## Siri, vriten 9 dhe palgosen 11 ushtarë

Nëntë ushtarë janë vrarë gjatë përleshjeve të armatosura me grupet rebele në Hama, në qendër të Sirisë. Gjithashtu, nga këto luftime janë plagosur 11 ushtarë të tjerë. Lajmin e ka bërë të ditur radioja private Sham FM.
Hama është epiqendra e revoltave ndaj regjimit të kryetarit Bashar Al-Assad. Shumë rebelë janë vrarë në zonën e Jisr Al-Mazareb të qytetit të Hamas dhe në këtë zonë janë sekuestruar edhe një sasi e madhe armësh.

## Pikturat e vjedhura të Pikasos u gjetën në Serbi

**Dy piktura të vjedhura të piktorit të famshëm Pablo Picasso, që vlejnë miliona dollarë, u gjetën në Serbi , njofton stacioni televiziv zviceran SF. Telvizioni zvicer-an emetoi deklaratën e prokurorit Schëyza Charles Fesler se di pikturat në vaj gjenden në një lokacion të sigurt, supozohet në Beograd. Fesler për Televizionin "SF" tha se Zvicra i kë dërguar kërkesën Serbisë që pikturat t'i kthhen, por nuk bëri të ditur se ku gjendn pëlhurat , si dhe emrat e hajnave, njofton AP.**










## Kakavijë, arrestohet me 13 kilogramë drogë

Një i ri 26-vjeçar, Erjon Trifoni, lindur në Fier dhe banues në Athinë si emigrant, është ndaluar në pikën e kalimit kufitar të Kakavijës si zotërues i një sasie prej 13 kg lëndë narkotike marijuanë. Trifoni udhëtonte drejt Athinës dhe ngarkesa gjendej në bagazhin e autobusit brenda një valixheje. Efektivat e Policisë Kufitare kishin marrë informacion më parë se një i ri nga Fieri do të trafikonte lëndë narkotike në drejtim të shtetit grek. Nga kontrolli i ushtruar, ka mbetur një valixhe që nuk pranonte asnjë pasagjer se ishte e tija, pasi kontrolli zbuloi se brenda saj ndodheshin lëndë narkotike…

## Pogradec, babai vret me sopatë djalin

Një 72 vjeçar vrau të shtunën djalin e tij, në fshatin Vërdovë, të Pogradecit. Policia tha se "72 vjeçari Njazi Kromollari ka qëlluar më sopatë djalin e tij Kundret Kromollari."
Policia tha gjithashtu se "25 vjeçari ishte përdorues i alkoolit dhe dhunonte fizikisht prindërit, dhe ngjarja ndodhi pas një gridjeje të çastit mes tyre, dhe autori i ngjarjes është arrestuar."





## Vlorë, sekuestrohen 33 kilogramë kanabis

Gjatë një operacioni të koduar "Mëngjesi", policia e Vlorës ka arritur të kapë një sasi prej 33.5 kilogramë kanabis sativa e presuar. Sipas policisë , gjatë një komunikimi për mediat se u arrestuan në flagrancë katër shtetas, banues të Vlorës. Ata akuzohen se në bashkëpunim me njëri-tjetrin pasi e blinin kanabisin në fshatin Kotë, e shisnin atë me sasi të vogla tek të rinjtë në qytet. Sipas deklaratës së policisë, të katër të arresuarit kishin më shumë se një muaj që ishin në përgjim nga policia, e cila e kreu operacionin saj mëngjesin e së dielës, në vendin e quajtur "Ura e Drashovicës". Të arrestuareve ju bllokua edhe një sasi monetare prej 4 mijë e 800 euro dhe 1.9 milion lekë.

# Pemët dhe perimet që duhet të hahen me lëvore



**KIVI:** Qimet të cilat ndodhen në lëvoren e kivit janë antioksidues i shkëlqyeshëm dhe nutricistët besojnë se posedon substanca që mbrojnë nga kanceri, infeksionet, alergjitë. "Lëvorja e kivit tri herë më shumë posedon antioksidues se sa fryti", thotë mjeku Merilin Glenvil, ish-presidenti i forumit për shëndet dhe ushqim në shoqatën mbretërore britanike për mjekësi. Si të hahen: Nëse ju duket lëvorja e kivit tepër e fortë, provoni të gjeni kivin "e artë", sepse membrana e verdhë është më e ëmbël dhe ka më pak "qime". Opsioni tjetër është që tërë kivin ta grimconi apo ta grini në mikser.





**BANANET: Një hulumtim i kryer në Tajvan tregon se lëvorja e bananes shëron depresionin ngase përmban shumë serotoninë, hormonin i cili është i caktuar për disponim më të mirë. Lëvorja është e mirë edhe për sy ngase përmban antioksiduesin, luteinë. Si të hahen: Mjekët këshillojnë që lëvorja të zihet dhjetë minuta dhe uji i zier të ftohet dhe të pihet.**

**ANANASI:** Mos bëni panik – lëvorja e fortë e ananasit është shumë e shëndoshë. Pos vitaminës C, ajo po ashtu ndihmon tretjen dhe mbron stomakun. Në lëvoren e ananasit gjenden dy herë më shumë antioksidues se sa në fryt. Si të hahen: Ndrydheni dhe grimcojeni membranën dhe shtoni lëng i cili do ta zbusë.



**LULELAKRA**: Fletët e lulelakrës janë më pak të shijshme, por në to gjenden shumë kalium dhe vitamina C", thotë Glenvil. Aty ka edhe shumë proteina dhe për një kohë më të gjatë do të jeni të ngopur. Si të hahen: Preni fletët në pjesë të holla dhe shtojani lulelakrës së fërguar apo të zier.





**PATATJA:** Shumica e njerëzve e ka kuptuar se lëvorja e patates është e shëndoshë, por shumica prej tyre nuk e dinë pse. është i pasur me hekur, magnez, zink dhe vitamina C. Si të hahen: Piqeni të plotë të lagur me vaj ulliri apo zieni dhe bëjeni pire pa ia hequr lëvoren.

**HUDHRA: Lëvorja e hudhrës në vete përmban pesë komponentë të ndryshëm, theksojnë ekspertët japonezë. Njëri nga funksionet më të rëndësishëm është ngadalësimi i plakjes dhe mbrojtja e zemrës. Si të hahen: Njomeni një thelb hudhre në vaj ulliri, pastaj piqeni bashkë me ushqimin në skarë apo shtojani gjellëve të përgatitura në furrë shporeti.**



## 9 - vjeçarit ia heqin nga barku vëllanë binjak



**DIPAKUT nga barku i janë varë duar dhe këmbë të vëllait të pazhvilluar binjak të cilin ia kanë hequr pasi që i kanë penguar. Fëmijët e fshatit të tij e kanë keqtrajtuar ndërsa madje disa edhe kanë hedhë gur.**

**Dipak Kumar (9 vjeç) nga India ka qenë i operuar në spitalin Fortis. Spitali prindërve u ka ofruar operacion falas pasi që harxhimet kanë qenë të mëdha, ndërsa familja nuk ka pasur mundësi ekonomike për ta lehtësuar djaloshin.**






# Berreta e John Wayne shitet për 180 mijë dollarë

NJË BERRETË e gjelbër e veshur nga legjenda e kinematografisë amerikane John Wayne në filmin e vitit 1986, “Berretat e Gjelbra”, është shitur për 180 mijë dollarë në një ankand.
Plot 5.3 milionë dollarë janë mbledhur deri tani nga shitja e mbi 700 objekteve të Wayne, kryesisht kostume dhe artikuj personalë, një pjesë e të cilës do të shkojë për fondacionin e Wayne kundër kancerit.
Ndërsa një pullë e zezë syri e përdorur nga Wayne në filmin e vitit 1969 “True Grit” u shit për 47.800 dollarë.
Ishte hera e parë që nga vdekja e aktorit që objektet e tij u shitën në ankandin e zhvilluar në Los Anxhelos. Berreta e gjelbër shënoi një cmim rekord, bëri të ditur Heritage Auctions, që organizoi ankandin.
John Wayne, i mirënjohur për interpretimet e tij në filmat western, ka performuar në më shumë se 150 filma gjatë karierës së tij 50-vjecare.





## Connie Smith me albumin e ri “Long Line of Heartaches”

Artistja legjendare në biznesin e shfaqjeve Dolly Parton dikur pati thënë se ka patur tre këngëtare të vërteta gra: Barbara Streisand, Linda Ronstadt dhe Connie Smith. “Ne të tjerët, tha ajo, vetëm pretendojmë se jemi këngëtare”. Connie Smith ka nxjerrë në treg albumin e saj të parë që nga viti 1998 me këngë të reja dhe i dyti që nga viti 1978. Kur 23-vjeçarja Connie Smith shkoi në studio në vitin 1964 për të regjistruar këngën e titulluar “Once a day”, askush nuk e dinte se ajo do të bëhej një nga këngëtaret solo më të dëgjuara në historinë e muzikës ‘country’.

## Pfeiffer: Nuk jam kundër kirurgjisë plastike



Michelle Pfeiffer nuk është kundër kirurgjisë plastike, por mendon se ndërhyrjet estetike duhen bërë me masë. Aktorja 53-vjeçare, e cila është ende një nga femrat më të dëshiruara të planetit, u shpreh për revistën ‘Elle’: “Nuk ka asgjë të keqe nëse njerëzit bëjnë një ndërhyrje të vogël për të eliminuar një defekt ose injektojnë botoks. Problemi vjen kur ndryshimi është rrënjësor dhe nuk je më vetvetja.” “Gjithsesi, nëse dikush shihet në pasqyrë dhe i pëlqen që fytyrën e ka zëvendësuar me një maskë, nuk ka fare problem”, shton Pfeiffer.

**Ish-anëtari i Beatles sir Paul McCartney këtë të diele u martua për të tretën herë kurse zgjedhura e tij do të jetë Nancy Shevell, trashigimtarja e biznesmenit të pasur amerikan.**





## Tech Talk

techflet@metro-ks.com



**NETBOOKU EEE PC X101H** i Asusit me rezolucion prej 1,024 x 600 piksel. Grafika e integruar GMA 3150, procesori është Atom N570 dybërthamësh i Intelit. Disku 320 GB. Kohëzgjatja e baterisë është deklaruar në mbi pesë orë, sistem operativ Windows 7 Starter.

# iPhone 4S në vend të iPhone 5



iPhone 4S është i ngjashëm me iPhone 4, por nga brenda është bukur shumë i ndryshuar. iPhone i ri ka procesorin A5 dybërthamësh me grafikën dybërthamëshe, e cila siç u tha gjatë paraqitjes është, madje shtatë herë më i shpejtë se ajo në iPhone 4. Është i përkrahur protokolli HSDPA për bartjen e të dhënave me shpejtësi prej 14.4 Mbps (iPhone 4 përkrahte atë HSDPA deri në 7.2 Mbps).iPhone 4S vjen me fotoaparatin krejtësisht të ri i cili tani ka rezolucionin prej 8 megapiksel. Fotoaparati është përmirësuar në mes tjerash për faktin se në Flickr numri i fotografive të marra me iPhone ka tejkaluar numrin e fotografive të bëra me fotoaparatet “e zakonshme” digjitale. Blendi tani i hapet me F2.4, ka lentën e përbërë nga pesë elemente dhe sjell mprehtësi për 30 për qind më të mirë si dhe gjallëri më të madhe të ngjyrave. Përkrah incizimin e HD videos në rezolucionin prej 1080p.Aty është edhe diçka që quhet Siri, sistemi i dallimit inteligjent të zërit me të cilin iPhone 4S do të mund të përgjigjet në pyetjet konkrete (në gjuhën angleze, franceze ose gjermane) siç janë për shembull “si do të jetë moti nesër?”, “sa është tani ora në Paris?”, “Si mund të arrij deri në lokacionin e dëshiruar?”, ”Ku ndodhet restoranti më i afërt italian?” dhe të ngjashme ... Siri krahas këtyre pranon edhe urdhëresa, siç është “më rikujto që nesër në 17:00 të thërras mikun”.iPhone 4S vjen me iOS 5. Është publikuar se iOS 5 do të jetë në dispozicion për shkarkim me 12 tetor, për shfrytëzuesit e iPadit, iPhoneit dhe iPod Touch. iPhone 4S do të kushtojë 199 USD (16GB), 299 USD (32 GB) dhe 399 (64 GB). Është ulur çmimi i iPhone 4 me 8 GB memorie në 99 USD, derisa iPhone 3GS me 8 GB memorie do të mund të merret pa pagesë në SHBA, vetëm me kontratën e operatorit. iPhone 4S do të jetë në dispozicion për blerje nga 14 tetori në SHBA, Gjermani, Kanada, Australi, Britani të Madhe, Francë, Gjeramani dhe Japoni, e nga 28 tetori edhe në rreth 15 vende të tjera të botës.











Libi: Luftëtarët e Këshillit Kalimitar synojnë kontrollin e Sirtes



**Disa qytete të tjera në jug të Libisë, të cilat forcat kryengritëse duhet t'i çlirojnë nga forcat pro-Gadafit: Mahmud Xhibril**

# Fortesa e fundit e Gaddafit

LUFTIME të ashpra po zhvillohen në rrugët e Sirtes, fortesës së fundit të Muamar Gaddafit në Libi, ku trupat e koalicionit po përballen për të dytën ditë radhazi me besnikët e mbetur të Kolonelit. Forcat e autoritetit të përkohshëm kanë marrë nën kontroll bulevardin kryesor thotë BBC, duke izoluar një qendër konferencash ku janë mbledhur njerëzit e Gaddafit. Me mijëra civilë vazhdojnë të mbeten të bllokuar në qytet. Luftëtarët e Këshillit Kalimtar u ndeshën me një rezistencë të ashpër nga snajperët pro-Gadafit ndërsa ata përpiqeshin të avanconin në vendlindjen e ish-pushtetmbajtësit. Një stuhi rëre që mbuloi Sirten e pengoi disi avancimin e forcave kundërshtare të Kolonelit. Por, marrja e kësaj rruge kyçe shihet si zhvillim tepër i rëndësishëm dhe mund të ndihmojë për të marrë vetë qendrën e qytetit. Sirte, gati 360 kilometra në lindje të Tripolit, është një nga pikat e fundit të qëndresës së Gadafit. Luftëtarët e qeverisë së përkohshme të Libisë kanë tre javë që po përpiqen të marrin kontrollin e këtij qyteti. Në momentin që Sirte bie, liderët libjanë do të shpallin çlirimin e vendit, edhe pse Gaddafi vetë vazhdon të mbetet në arrati.

Sekretari britanik i mbrojtjes, Liam Fox, i cili ishte në Libi të shtunën, u zotua për vazhdimin e sulmeve ajrore të NATO-s edhe nëse Sirte kalon në duart e forcave të Këshillit, duke thënë se veprimet ushtarake ndërkombëtare nuk do të reshtin për sa kohë elementet pro-Gadafit do të vazhdojnë të kërcënojnë popullin e Libisë.




## Gjermania planifikon ndihmë për libianët

**Qeveria gjermane planifikon të sjellë me avion për trajtim në Gjermani të plagosur rëndë nga Libia.**
**Synimi është që të plagosurit të marrin shpejt ndihmën mjekësore urgjente, që u duhet, tha një zëdhënës i Ministrisë së Jashtme në Berlin.**



**Gjermania është aktualisht i vetmi vend i BE-së, që u jep viktimave të dhunës nga Libia leje hyrjeje, u tha në Ministrinë e Jashtme.**
**Sipas të dhënave të Këshillit Kalimtar gjatë luftimeve të muajve të kaluar për rrëzimin e regjimit Gaddafi janë plagosur rreth 50.000 vetë.**

# Biznes dhe Financa

biznesdhefinanca@metro-ks.com



**Robert Zoelick kryetar i Bankës Botërore**

## Zoellick kritikon qeverinë gjermane

PA KONCEPT, pa vizion: Presidenti i Bankës Botërore, Robert Zoellick ka kritikuar ashpër qeverinë gjermane. Ai akuzon Merkelin se po i del ballë krizës pa plan të qartë. Kjo do të kushtojë më shumë, ka thënë ai.

Vërtet tonet nga Uashingtoni nuk janë miqësore. Presidenti i Bankës Botërore, Robert Zoellick ka kritikuar me tone të ashpra mungesën e rolit udhëheqës të Gjermanisë në krizën e euros. Kancelarja Merkel nuk ka treguar vizion për kapërcimin e krizës, ka thënë Zoellick në një intervistë të botuar pjesërisht në "Javën Ekonomike".

**Ku janë vizionet?**

"Shumë gjëra në politikë bëhen si me zor, pa vizion, por ekonomia dhe tregjet kanë nevojë për orientim dhe qartësi", ka theksuar Zoellick. Kur para 20 vjetësh u shpërbë blloku lindor, kancelari i atëhershëm Helmut Kohl kishte një vizion, se si duheshin zhvilluar gjërat. Kjo tani mungon, dhe sa më shumë që të zgjasë kjo gjendje, aq më shumë para kushton kjo, dhe aq më pak opcione për zgjidhje do të ketë".

Angela Merkel me Robert Zoellick u takua këtë të enjte për krizën në eurozonë - tanimë vjen sulmiAngela Merkel me Robert Zoellick u takua këtë të enjte për krizën në eurozonë - tanimë vjen sulmi. Presidenti i Bankës Botërore, Zoellick kritikon se Evropa ende nuk e ka një koncept se si duhet ta zgjidhë krizën. Me ombrellën e shpëtimit, sipas tij, evropianët vetëm se kanë fituar pak kohë. "Nuk dua ta kritikoj këtë, por kjo nuk e zgjidh problemin."

**Taksapaguesve nuk u jepet një kurs i qartë**

Zoellick i bëri thirrje Gjermanisë të marrë më shumë përgjegjësi për të zgjidhur krizën. "Gjermania edhe për shkak të madhësisë së saj, luan një rol të rëndësishëm". Ai kujtoi se vende të tjera të rëndësishme si Franca apo Italia janë të zëna aktualisht më shumë me problemet e tyre. "Presidenti i Francës, Nicolas Sarkozy ndodhet para zgjedhjeve presidenciale, Italia po përfshihet nga turbulencat, Britania e Madhe nuk është pjesë e eurozonës."

Taksapaguesit gjermanë duan t'u tregohet një kurs i qartë, kanë thënë Presidenti i Bankës Botërore,"që udhëheqja politike t'u thotë, se në çfarë rruge po shkon Evropa, nëse do të krijohet një union politik dhe financiar për të mbrojtur eurozonën. "

Që në fillim të shtatorit erdhi kritika e parë nga shefi i Bankës Botërore, duke paralajmëruar se ekonomia botërore "po hyn në një zonë të re rreziku." (DV)

## Rritet trysnia mbi Greqinë



**Përfaqësuesit e treshes ndërkombëtare, të përbërë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, nga Banka Qendrore Evropiane dhe nga Komisioni Evropian, janë të pakënaqur me përpjekjet për reforma në Greqi. Është e qartë që plani i kursimeve nuk funksionon deri tani. Vendi bën dy hapa para dhe një prapa, u tha. Nevojiten reforma shumë më të ashpra, tha Poul Mathias Thomsen si përfaqësues i FMN-së. Grekët besojnë se mjafton bërja e ligjeve, por kjo nuk mjafton, shtoi ai. Krerët e shteteve dhe të qeverive të eurozonës e varin pagesën e transhit të ri të ndihmës për Greqinë nga një gjykim pozitiv i së ashtuquajturës treshe. Fjala është para së gjithash për atë, nëse Greqia është në gjendje t'i shlyejë huat e saj të mëdha. Pa kredi të reja vendi i eurozonës do të ishte prej nëntorit i paaftë për të paguar.**

## 900.000 euro për rindërtimin e shtëpive në veri



Qeveria e Republikës së Kosovës, nga fondi i rezervave ka ndarë 900.000 euro për rindërtimin e shtëpive në veri të Kosovës.

Vendimi, sipas Radio Televizionit të Kosovës ka qenë unanimisht i miratuar nga ministrat e qeverisë së kryeministrit Hashim Thaçi. Qeveria kosovare, gjithashtu komunikoi se në fund të muajit do të fillojë me dhënien e pasaportave biometrikë.






# Metro marketing

metromarketing@metro-ks.info

**Metro marketing, me dy faqe mundësi për t'u punësuar, për të publikuar njoftimet, shpalljet, shitblerjet.**
**Konkurroni në konkurset e shpallura. Mundësia është kjo: Plotësoni formularin dhe së bashku me CV-në e dërgoni në adresën: info@metro-ks.com.**
**Për ata që dëshirojnë të publikojnë shpalljet, pagesën duhet ta bëjnë në xhirollogarinë e gazetës METRO: xxxxxxxxxxxxx, pasi ta kenë marrë kodin, në bazë të të cilit indentifikohen.**


L FOCUS
044-049/510-100

VTH
VITE TERM & HIDRO
BËJMË INSTALIMIN E NXEMJEVE QËNDRORE, UJËSJELLËSIT DHE KLIMATIZIMIT
Mob: 044/049 25 40 25


## Gazeta METRO - KS shpall

# KONKURS

1.
**Gazetarë:**
**Kushtet:** Të kenë prirje për gazetari, të njohin të paktën një gjuhë të huaj si dhe punën me kompjuter.

2.
**Korrespodentë:**
**Kushtet:** Të kenë prirje për gazetari, të njohin të paktën një gjuhë të huaj, si dhe punën me kompjuter.

3.
**Lektorë:**
**Kushtet:** Ta kenë të kryer Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Ta njohin drejtëshkrimin e gjuhës shqipe dhe punën me kompjuter.

4.
**Fotoreporterë:**
**Kushtet:** Të kenë prirje për fotografi, të njohin punën me kompjuter.

5.
**Bashkëpunëtorë:**
**Kushtet:** Të kenë prirje për gazetari, të njohin të paktën një gjuhë të huaj si dhe punën me kompjuter

Kokurrimi bëhet në adresën:
info@metro-ks.com

## Metro Klasfikimi


049 128 542
Reklamo këtu


## Shpallje

Shëroj me barishte natyrore këto sëmundje: hemorroidet (majasëllin) e bredshëm dhe të jashtëm, astmën bronkiale, lukthin, psoriazën, prostatën (urinimin). Halil Kajtazi, **Tel: 038 229 193, o49 526 108, 044 181 549.** Adresa: Kodra e Diellit, rruga "Ali Kelmendi", nr. 25, Prishtinë.

## Gazeta METRO - KS shpall

# KONKURS

1.
**Shpërndarës të Gazetës për qendrat: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Freizaj dhe Gjilan.**
**Kushtet:** Mosha 18 deri 25 vjeç.

2.
**Agjentë të Marketingut**
**Kushtet:** Përgatitja përkatëse profesionale; aftësi komunikimi.

3.
**Designer:**
**Kushtet:** T'i njohë programet për dizajnimin e gazetës: Adobe InDesign, Adobe Photoshop, Adobe Illustrator etj. Të sjell me vete disa punë personale.

4.
**Web Designer:**
**Kushtet:** T'i njohë programet adekuate për krijimin dhe mirëmbajtjen e web faqës si dhe të sjell me vete disa punë personale.

5.
**Shofer:**
**Kushtet:** Patentë shoferi - kategoria B.

Kokurrimi bëhet në adresën:
info@metro-ks.com


nikadizajn
dizajn · reklama · gravurë · shtyp

NikaDizajn
Dardani Rr.28 Nentori
10000 Prishtinë,
Tel. 038 550 130
Mob. 044 555 006
044 600 157
nikadizajn@hotmail.com
www.nikadizajn.com

Reklamo këtu 049 128 542
marketing_metro-ks.com

KAF
Nëse mendoni se nuk mund t'i mbani nën kontroll librat e juaja të kontabilitetit, atëherë kërkoni ndihmën tonë.
Kontabilitet | Auditim | Financa
www.kaf-ks.com, info@kaf-ks.com, +377 (0) 44/ 226 - 940


# KONKURS


APP
Agjencia e punesimit PUNËSOHU


Agjencia private e punësimit "Punësohu" ofron mundësi punësimi në Irak, Afganistan, Kuvajt etj., përmes kompanisë amerikane "FLUOR" dhe "KBR". Po ashtu ofron mundësi punësimi në kompani, institucione dhe organizata të ndryshme në Kosovë. Gjendemi afër qendrës tregatre BEN-AF në Ulpianë - Prishtinë (përballë selisë së AAK-së). Tel: 045-569-039 , punesohu@live.com, www.punesohu.org


Reklamo këtu
049 128 542


## Shitje

Shes **Golf 3/1.8 Benzin-Plin**, ngjyrë e zezë, viti **1992**. Ka regjistrim deri më **17.5.2012**, është në gjendje shum të mirë. Na kontaktoni në telefonin: **044/ 744-327** dhe **049/ 324-450.**


Reklamo këtu
049 128 542

Reklamo këtu
049 128 542
marketing@metro-ks.com


## "R I O"
**Aksion, Aventurë, Komedi**
**Kohëzgjatja 1 orë 36 min.**



TEMA: "Rio" është një film i animuar i metrazhit të gjatë nga autorët e filmave "Ice age". Filmi komedi, me plot aventura, flet për makaun, i cili vjen në Rio de Zhaneiron e bukur. Makau mendon që është i fundit nga raca e tij. Por, kur kupton që ekziston edhe një makau tjetër, femër, ai ikën nga kafazi i tij dhe niset për në Rio. Por, dashuria nuk vjen në shikim të parë. Femra ishte ndryshe. Ajo ishte e rritur ndryshe dhe e pavarur, jo si Makau, që ishte i butë dhe i qetë. Por, duke u shoqëruar së bashku dhe duke jetuar bashkë për një kohë, ata mësojnë për miqësinë, për dashurinë dhe për trimërinë...

**Rolet:** Jesse Eisenberg, Anne Hathaway, George Lopez, Tracy Morgan, Jemaine Clement. **Regjia:** Carlos Saldanha
**Filmi RIO shfaqet te shtunën dhe të dielën në ora 13:00 dhe 15:00**



melita
**Zgjidhje komplete për kontabilitetin dhe financat e kompanisë tuaj në një vend.**
Implementim | Konsulentë | Trajnim | Licenca
Melita&Parners | 038725930 | info@melita-parners.com

RIN'NORA
make-up & nails
make up
044/ 793 346
nails:
044/ 793 347
Adresa: Kodra e Trimave
Rr. Shemsi Haziri (përballë furrës "LINDI") - Prishtinë

AUTO TRANSPORTUES 24h
QELI SERVICE




Lidhja Auto-Moto e Kosovës
League Auto-Moto of Kosova


Lidhja Auto-Moto e Kosovës-LAMK e themeluar në dhjetor të vitit 2010 konform ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor vepron në bazë të principit të organizimit të organizatave simotra Europiane siç janë: ADAC, FIA, ITA, etj., si dhe të atyre në shtetet fqinje të cilat janë me mjaft sukses duke vepruar dhe duke kryer shërbime për automobilistët apo pronarët e automjeteve në vendet e tyre. LAMK është përkujdesur që të formojë dhe konsolidojë shërbimin për ndihmë dhe informata në rrugët e Kosovës e më gjerë, duke ofruar shërbimin e ndihmës dhe informatës për të gjithë automobilistët apo pronarët e mjeteve të regjistruara në Kosovë, të cilët janë të anëtarësuar në LAMK dhe të cilët kërkojnë këtë shërbim nga LAMK përmes numrit karakteristik të telefonit.

**Për më shumë:** Adresa: Lagja e Spitalit, Objekti 2, Kompleksi "Luledielli" 10.000 Prishtinë/Kosovë
Telefoni: + 377 (0) 44/184-400; + 377 (0) 44/145-807
E-mail: **lamk-ks@hotmail.com**

## FALJA E GJAKUT
**Zhanri: Dramë; Kohëzgjatja: 1 orë 49 min.**



TEMA: Niku është një djalë 17-vjeç në vitin e tij të fundit të shkollës së mesme në Shqipërinë Veriore. Ai fillon romancën e tij të parë me një vajzë nga klasa e tij dhe planifikon të hap një internet kafe pas mbarimit të shkollës. Motra e tij, Rudina, një vajzë e zgjuar, 15-vjeçe dëshiron të shkojë në kolegj. Kur një konflikt lokal mbi një copë toke rezulton në akuzimin e babait të tyre Markut për vrasje, familja futet në një armiqësi gjaku vdekjeprurëse. Ligjet e Kanunit, kodit të vjetër ligjor Ballkanik, detyrojnë Nikun, vëllain e tij 7-vjeç dhe anëtarët e tjerë meshkuj të familjës, që të mbyllen në shtëpi pothuajse sikur në arrest shtëpiak...

**Në rolet kryesore:** Tristan Halilaj, Refet Abazi, Zana Hasaj, Luan Jaha, Çun Lajçi, Veton Osmani, Selman Lokaj, Sindi Lacej, Ilire Vinca Çelaj, etj. **Regjia:** Joshua Marston. **Skenari:** Andamion Murataj.

**Filmi shfaqet në ora 18:00, 20:00 dhe 22:00.**



Të shtunën më 15 Tetor 2011
**Teatri kukullave " DODONA" shfaq "Pula këlloçkë e Abës loçkë"**
Ora: 12:00; Tel: 038 230 623
E-mail: dodona1986@yahoo.com


Reklamo këtu
049 128 542
marketing_metro-ks.com

# SUDOKU

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 3 | 6 | | 4 | 9 | | | |
| | 5 | | | 7 | | 6 | | |
| 9 | | 1 | 5 | | 8 | | 3 | |
| 3 | | | | 9 | | 5 | | 2 |
| | 6 | | 3 | | 5 | 4 | | |
| | 2 | 4 | | 8 | 6 | | 1 | |
| | 4 | | | | 7 | 8 | 2 | |
| | 1 | | | 5 | | | 4 | 6 |
| 8 | | 2 | | 3 | | | 7 | |

I lehtë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 9 | | | | | 2 | | |
| | | | 3 | 6 | 9 | | | |
| 7 | | 3 | | | 5 | | | |
| 9 | | | | | 7 | 4 | | 8 |
| 5 | | | 9 | | 8 | | | 7 |
| 4 | | 7 | 1 | | | | | 2 |
| | | | 6 | | | 5 | | 4 |
| | | | 4 | 5 | 3 | | | |
| | | 4 | | | | | 7 | 3 |

Mesatar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 6 | | | 2 | | | |
| 4 | 2 | | | 7 | | | 8 | |
| 5 | | | 1 | | 3 | | 2 | 4 |
| 6 | | 1 | | | | | | 5 |
| | | 5 | | 9 | | | | |
| | | | 3 | 4 | | 1 | | 2 |
| | | | | 3 | 4 | 8 | | 6 |
| 1 | 7 | | | | 6 | 3 | | 9 |
| | | | | | | | | |

I ndërlikuar

SUDOKU është enigmë me numra në tabelën me 9x9 fusha. Kjo tabelë ndahet përsëri në 9 katrorë ku secili ka 3x3 fusha. Në këto fusha shënohen numrat prej 1-9, ku asnjëri numër nuk guzon të përsëritet as horizontalisht as vertikalisht në kolonat e katrorit të madh 9x9 dhe as në fushat e nënkatrorëve të vegjël 3x3. Niveli i vështirësisë së kësaj enigme varet ga sasia e numrave të gatshëm (si ndihmesë) të paraqitur nga përpiluesi. Enigma Sudoku e ka origjinën nga Japonia.

# HOROSKOPI

DASHI (21.3-20.4)
**Puna:** Projektoni sipas ideve tuaja
**Shëndeti:** Konsumoni pemë dhe perime
**Dashuria:** Partneri ndjen se është braktisur

DEMI (21.4-20.5)
**Puna:** Nganjëherë thyeni rregullat
**Shëndeti:** Këshillohuni me mjekun tuaj
**Dashuria:** Jeni me fat

BINJAKET (21.5-20.6)
**Puna:** Dita juaj e fatit
**Shëndeti:** Shqetësoheni së tepërmi për shëndetin
**Dashuria:** Komunikoni më shumë

GAFORRJA (21.6-20.7)
**Puna:** Gjithçka do të vijë në vend të vet
**Shëndeti:** Gjendje e mirë
**Dashuria:** Lidhja juaj është e brishtë

LUANI (21.7.20.8)
**Puna:** Një ditë e tensionuar
**Shëndeti:** Kujdes mbipeshën
**Dashuria:** Bëni të ndjehet me fat

VIRGJERESHA (21.8-20.9)
**Puna:** Moment vendimtar për të ardhmen
**Shëndeti:** Gjendje e mirë
**Dashuria:** Jeni të lumtur

PESHORJA (21.9-20.10)
**Puna:** Do të fitoni financiarisht
**Shëndeti:** Dhimbje eshtrash
**Dashuria:** Harmonizoni lidhjen

AKREPI (21.10-20.11)
**Puna:** Keni arritur siguri financiare
**Shëndeti:** Mos e teproni me ushtrime
**Dashuria:** Gjithçka nis nga ju

SHIGJETARI (21.11-20.12)
**Puna:** Menaxhoni shpenzimet
**Shëndeti:** Pa probleme
**Dashuria:** Kaloni mosmarrëveshjet

BRICJAPI (21.12-20.1)
**Puna:** Krizë financiare
**Shëndeti:** Bëni disa analiza
**Dashuria:** Qëndroni pranë njëri-tjetrit

UJORI (21.1-20.2)
**Puna:** Të tjerët nuk i zgjidhin problemet tuaja
**Shëndeti:** Kokëdhimbje
**Dashuria:** Do t'ia fitoni zemrën

PESHQIT (21.2-20.3)
**Puna:** Vendimi juaj është i duhuri
**Shëndeti:** Relativisht mirë
**Dashuria:** Vetëm ju keni rëndësi





# Toyota para Mercedesit dhe BMW-së

TOYOTA këtë vit mori çmimin si prodhuesi më i madh i veturave në botë.
Sipas të dhënave të organizatës Interbrand, e cila tash 37 vjet analizon gjendjen në tregun e veturave, Toyota realizon rezultatet më të mira të cilat kontribuojnë në ngritjen e vlerës së brendit, kurse në mesin e shumë kritereve , një nga më të rëndësishmet është afarizmi financiar si dhe emri i brendit gjatë blerjes së veturave.
Suksesi i prodhuesit japonez fiton edhe më shumë në vlerë për shkak të faktit se kohë më parë madje ishin të preokupuar me thirrjet e shumta të përdoruesve të veturave të tyre, termetet shkatrruese që ndikuan në mbylljen e ndërmarrjes por edhe me krizën globale ekonomike.
Në vendin e dytë gjendet Mercedesi, që ka bërë më së shumti ndryshime në performansë, në disejn dh në siguri .Sipas Interbrand, për shkak të elementeve të sipërpërmendura , blerësit të cilët i janë besnik me yllin trerrembësh.
BMW arriti në vendin e tretë në rend të parë duke iu falënderuar përkatësisë së tyre të "verdhë", kurse EfficientDynamics e tyre tregon rrugën se si duhet përparuar të gjithë prodhuesit. Pas kësaj treshe renditen prodhuesit Volkswagen, Ford, Audi, Hyundai, Porsche, Audi dhe Ferrari.

## Veprimet me bizare në timon

**Policia britanike vendosi që të nis një aksion dhe të qërojë hesapet me shoferët e pandërgjegjshëm, duke i hetuar se çfarë bëjnë gjatë vozitjes. Kanë pritur se shoferët do ti zënë duke telefonuar apo dërgojnë mesazhe, mirëpo, ajo në çka ata hasën i la pa fjalë. Një mashkull gjatë drejtimit të veturës pinte kafe, shkruante në llaptop dhe mbushte fjalëkryqin në gazetë. Tjetri qëronte dardhën dhe në të njëjtën kohë telefononte. Nga policia britanike iu bë thirrje shoferëve se me sjelljet e tyre ata po e rrezikojnë veten , por edhe pjesëmarrësit e tjerë në trafik dhe duhet të sillen esull në timon...**




Prodhimet e kompanisë
*Llokum me arra, aromë, fëstëk, kokos, mentol * Karamele me lajthi dhe fruta **"KARAMELE"** , **"FRUTIS"** * Bonbone te forta te shijeve te ndryshme **"SWEET BON"** , **"KIDO BON"**, **"COLA BOON"** * Hallvë vanile kakao dhe fëstëk * Sulltan llokum * Zhele bonbone * Vafel-Napolitankë me krem qumështi,kafe,lajthije dhe çokollate) **"WAFERIA"** * Çoko-llokum **"PRALINE"** * Biskota **"SEMPRE"** dhe **"PERFETTO"** * Lollipop






# Televizioni Kabllor dhe Digjital

## RTK

**E hëne 10 tetor**

07:00 PROGRAMI I MENGJESIT
Programi i pasditës
15:00 LAJMET E ORES 15:00
15:10 PROMO RTK
15:10 TARGET -STANDARDI GJUHESOR
16:31 TOP SHOP
16:44 VIDEOKLIPE
17:00 KFOR SHQIP:BLOOD DONATION
17:00 LAJMET E ORES 17:00
17:15 MOTI
17:16 KFOR SHQIP:BLOOD DONATION
17:17 PROMO RTK
17:20 MAGAZINA NE GJUHEN SERBE: NEDELJNI KOLAZ
18:20 PROMO
18:23 LAJMET NË GJUHËN TURKE HABER
18:38 MARKETING 1
18:40 LAJMET NË GJUHËN BOSHNJAKE
18:55PROMO
19:00 KFOR SERBISHT:PROMOTE LMT
19:00 LAJMET NE GJUHEN SERBE VESTI
19:15 KFOR SERBISHT:TRAFFIC SAFETY
19:16 VIDEOKLIPE
19:23 KFOR SHQIP:PROMOTE LMT
19:30 LAJME 19:30
20:04 10 MINUTA
20:17SPORT PLUS
20:22 SERIAL VENDOR: KAF-ENEJA JONE EP
21:03 KUSH DO TE BEHET MILIONER
22:02 SUBVENCION
23:00 LAJMET E ORES 23:00

23:30 PA SKENAR



## 21

**E hëne 10 tetor**

07:00 Flash
07:20 Programi i mëngjesit "Për ditë të mbarë"
08:00 Flash
08:15 Programi i mëngjesit "Për ditë të mbarë"
09:00 Flash
09:05 Smart shop
09:15 Serial – "Favoritja"
10:00 Flash
10:05 Smart shop
10:30 Emision dokumentar
11:00 Flash
11:05 Emision dokumentar – (vazhdim)
11:30 Top Hop Hiti – emision për fëmijë
12:00 Flash
12:05 Smart shop
12:10 2 me 1 – emision i sportit
13:00 Flash
13:05 2 me 1 – (vazhdim)
13:50 Smart shop
14:00 Flash
14:05 Bon Bon – magazinë televizive



Mysafirë në studio, Kuriozitete nga bota,
Reportazhi: "Kështu thonë qytetetarët"
15:00 Flash
15:10 Bon Bon – (vazhdim)
16:00 Flash
16:05 Smart shop
16:10 Serial – "Favoritja"
17:00 21 Drejtperdrejt
17:30 Emision dokumentar
18:00 VOA
18:30 Reklama
18:35 Ditari
19:05 Sporti
19:10 Reklama
19:15 Fjalë të urta
19:20 Film vizatimor
19:30 Edhe unë jam Kosovë
Trajtohet gjendja sociale e familjeve kosovare
20:00 Flash
20:05 Kabare
21:55 Reklama
22:00 21 Minuta
22:35 Sporti
22:40 Reklama
22:45 Serial-"Favoritja"
23:45 Just Kidding
00:00 Flash

## KTV Kosova

**E hëne, 10 tetor**

07:00 Ora 07/00
09:30 Sistina emision i shëndetësisë Dr. Daniela Projevska
09:50 Film Vizatimor: Aventurat e Komandantit Kusto
11:00 Emisioni: Zona e Debatit (R)
12:50 Publicitet
13:00 Lajmet 13/00
13:30 Moti
13:35 Serial: Anatomia e Greit
14:15 Trip Lista – top lista muzikore (R)
15:00 Lajmet Flash
15:15 Kutia
16:30 Seriali: Alias
17:30 INFO Magazine – emision informativ (
18:20 Ora e Pasditës Pjesa 1 Ora e Pasditës pjesa 2
19:40 Takimi – emision informativ, kulturor
20:00 Lajmet 20/00
20:35 Moti
20:45 Zona B



21:30 Fringe
22:30 Lajmet 22/30
23:02 Moti me Nekin
23:10 Minuta e Fundit
00:00 Seriali: Alias
00:45 Zona B (R)
01:20 Info Magazine
02:00 Ora e Pasditës (R)
03:15 Lajmet 22/30
03:45 Moti
03:50 Takimi (R)
04:00 Fringe
05:00 Minuta e Fundit (R)
05:45 Sistina emision i shëndetësisë Dr . Daniela Projevska
06:00 Video Gazmore
06:30 Kenga Magjike

# Festa e shfrenuar e beqarisë

Duhej të ishtë një festë beqarie e paharrueshme dhe ia arriti qëllimit; Tetë meshkuj në Britaninë e Madhe, tashmë duhet t'i nënshtrohen testit për të provuar atësinë pas festës së beqarisë së njërit prej tyre, festë e cila degjeneroi në orgji.
Festa ka zgjatur disa ditë dhe u zhvillua në një qytet të Gjermanisë. Tetë meshkujt, për të festuar kishin marrë një balerinë striptiste. Por, mesa duket jo gjithcka ishte planifikuar sic duhet. Në fund të shfaqjes, striptistja 20 vjecare e gjeti veten në shtrat me të tetë meshkujt.
Tashmë, 20 vjeçarja ka një fëmijë 16 muajsh, atësia e të cilit ajo pretendon se është e njërit prej tetë meshkujve që kishte festuar kohë më parë. Për këtë ajo ka depozituar një kërkesë në gjykatën gjermane. Gjykata vendosi që të kryhet testi i atësisë.
Sipas vendimit të gjykatës dhe ligjit gjerman, 8 "partnerët" do t'i nënshtrohen testit të ADN-së për të verifikuar se cili prej tyre është babia i fëmijës. Pas testit, babai detyrohet të paguajë një shumë të caktuar mujore për mirërritjen e foshnjes së tij.



## Formula 1: Çmimi i madh i Japonisë

# Vettel fiton titullin e dytë me radhë



SEBASTIAN Vettel është konfirmuar mbreti i Formula 1. Gjermani i Red Bull fitoi titullin e dytë radhazi falë vendit të tretë të fituar në Suzuka.
U kurorëzua kështu me sukses puna e skuadrës austriake dhe e pilotit gjerman, të cilët dominuan sezonin nga fillimi. Rivalët e tij nuk kanë mundur të bëjnë asgjë duke u detyruar t'i japin lamtumirën trofeut. 24-vjeçari Vettel thyen rekordin e Fernando Alonsos dhe hyn në historinë e Formula 1 si piloti më i ri në moshë që fiton dy tituj kampion bote. Çmimi i Madh i Japonisë u fitua nga Jenson Button me Mclaren ndërsa në vendin e dytë u rendit ferraristi Fernando Alonso.
Ngacmimet mes Lewis Hamilton dhe Felipe Massa vazhduan edhe në Suzuka. Anglezi ka prekur sërish makinën e brazilianit të Ferrarit, por për fat të mirë asnjëri prej tyre nuk pësoi dëme të mëdha duke arritur të mbyllin garën. Hamilton në vendin e pestë ndërsa Masa në të shtatin. Kampioni i ri tashmë është shpallur, ndërkohë që në katër garat e mbetura, Button, Alonso, Webber dhe Hamilton do të luftojnë për vendin e dytë.








## FOTBOLL

# Rooney: Një idiot në qarkullim

"NJË IDIOT në qarkullim", ky është titulli metë cilën "Ties" vendos në faqen kryesore, duke iu referuar kartonit të kuq të marrë në gjaknxehtësi e sipër nga sulmuesi Rooney, në barazimin 2-2 të arritur në Malin e Zi, në një ndeshje kualifikuese të Euro 2012. Jo më pak të ashpra edhe titujt e gazetave të tjera që nënvizojnë faktin se sjellja e papjekur e yllit të Manchester United rrezikoi të vendoste në rrezik kualifikimin për në evenimentin që do të zhvillohet vitin e ardhshëm në Poloni dhe Ukrainë. "Ishte një gjest tërësisht i pajustifikueshëm, një budadallëk që mund t'i kushtonte shtrenjtë kombit të tij", komentonte "Daily Mirror". Një pjesë e madhe e mediave e lidhi presionin me të cilin Rooney luajti në fushën e lojës me stresin që mund t'i ketë krijuar arrestimi i babait, i vendosur nën pranga vetëm një ditë më parë, për përfshirjen në një rrjet bastesh të paligjshme.



**Wayne Rooney, në thumb të kritikave të shtypit anglez**

## HENDBOLL: KUPA E EHF-së

# Prishtina dhe Kastrioti "kafshatë e lehtë" për Arkatronin dhe Otelulin

HENDBOLLISTET e Prishtinës dhe ato të Kastriotit të Ferizajt, kanë pësuar humbje në të dy takimet në kuadër të kupave evropiane. Prishtinaset janë mposhtur para tifozëve të vet nga skuadra bjelloruse, Arkatron, me rezultat 33:24 dhe 29:23, në dy ndeshjet e rrethit të dytë të Kupës së EHF-së. Ndërkaq, ferizajaset nuk kanë arritur t'u bëjnë fare qëndresë rumuneve të skuadrës Otelul Galati, duke pësuar humbje të thellë, me rezultat 45:14 (në ndeshjen e parë) dhe mbrëmë 39:21. Ndeshjet e skuadrave kosovare dëshmuan edhe një herë se në këtë sport ende nuk jemi të gatshëm për garat e mirëfillta ndërkombëtare.



**Pamje nga ndeshja Prishtina - Arkatroni** Foto: Albaspox

## futbollshkurt



**Flamur Rexhaj kampion absolut i Kosovës**

### Flamur Rexhaj numri një i Kosovës

FLAMUR REXHAJ, fitoi titullin e kampionit të Kosovës në kategorinë absolute, në shfaqjen e organizuar nga Federata e Bodibilldigut e Kosovës, që u mbajt të shtunën në Gjakovë. Pas tij u renditën Arsim Kullasi dhe Xhevdet Lepaja. Mazllum Shaku ishte i pari në kategorinë e lehtë, Ali Bojkaj në kategorinë e mesme dhe Egzon Hyseni – gjysmë të rëndë. Morën pjesë mbi 30 bilderë të të gjitha kategorive.

### Spanja afër rekordit

**ME suksesin e arritur në Pragë përballë Republikës Çeke, Spanja është vetëm një fitore larg rekordit absolut, të mbajtur nga përfaqësuesja e Holandës, prej 14 fitoresh radhazi në ndeshjet zyrtare. Nëse ditën e martë, në Alikante, do të regjistrohet një sukses edhe përballë Skocisë, atëherë do të barazohej rekordi i mbajtur nga përfaqësuesja e "tulipanëve". Për më tepër, Spanja ka 21 fitore radhazi.**

### Mazzari: Juventus është favorit



TRAJNERI i Napolit, Valter Mazzari ka favorizuar liderin e kampionatit italian, skuadrën Juventus për titullin e kampionit të sivjetmë në Serie A. Sipas tij Napoli po fokusohet më tepër në Evropë. " Është e vërtetë që thonë se Napoli është i fortë, por vetëm në Evropë, Juventus është favorit në Serie A ngase nuk është shumë i ngarkuar me ndeshje, besoni në këtë që e them ngase po rrespektohem tani si trajner, e që gjatë pjesës më të madhe të karrierës ishte i nënvlerësuar nga të gjithë" tha Mazzari.

UEFA EUROPA LEAGUE
VEND I REZERVUAR PËR BASTORE... REZERVO TANI 044/ 200 300
Bast

# SPORT



Rooney: Një idiot në qarkullim >F31

## Mënjanuest për EURO 2012

# Të martën qartësohet gjithçka

TË PREMTËN u zhvillua xhiroja e parafundit e ndeshjeve mënjanuese për kampionatin evropian të futbollit që mbahte në Ukrainë dhe Poloni. Turqia në Grupin A u mposhtë keq nga Gjermania 3:1, duke humbur pozitën e dytë në renditje të cilën ia rrëmbeu Belgjika e cila mundi Kazakistanin 4:1. Për përzgjedhësin Gus Hidink e vetmja shpresë sërish mbetet Gjermania e cila në ndeshjen e fundit pret në shtëpi Belgjikën kurse Turqia Azarbajxhanin. Rusia mundi në udhëtim Sllovakinë 1:0, dhe ruajti kryesimin në Grupin B, kurse në Grupin C, Serbia dhe Italia luajtën baraz në Beograd 1:1. Italia tashmë e ka siguruar Pjesëmarrjen ndërkohë që për pozitën dy do të luftojnë Serbia dhe Estonia. Serrbia në rast të fitores kundër Slovenisë në udhëtim mund të rimarr këtë pozitë pasi Estonia i ka kryer të gjithë ndeshjet dhe me një pikë më shumë zë ozitën e dytë në grup. Përfaqësuesaj e Shqipërisë edhe në ndeshjen e dytë kundër Francës të cilën e zhvilloi në Paris, e humbi 3:0 dhe është ky një bilanc tejet i dobët i kombëtares kuq e zi, e cila drejtohet nga kroati Josip Kuzhe. Ndeshjen e fundit në Grup, Shqipëria e zhvillon nesër në shtëpi kundër Rumanisë.



Pamje nga ndeshja Franca - Shqipëria 3:0 Foto: DayLife

## Nëshkimi...

PORTIERI Samir Ujkani dhe sulmuesi Hamdi Salihi ishin lojtarët më të dobët në fushën e lojës në humbjen 3:0 të kombëtares sonë në Paris. E përditshmja "Le Parisien", vlerësonte me notën 3 portierin e kombëtares sonë. Nga ana tjetër, notën më e ulët e dhënë midis të gjithëve në fushën e lojës e ndante edhe Salihi. "I vetëm në sulm, pjesërisht prej dominimit të kombëtares sonë, por edhe sepse nuk kërkoi kurrë top"..

**Grupi D**

| | |
|---|---|
| Franca-Shqipëria | 3:0 |
| Bosnje e H.-Luksemburgu | 5:0 |
| Rumania-Bjellorusia | 2:2 |

| | | |
|---|---|---|
| 1. Franca | 9 | 20 |
| 2. Bosnije e & Her. | 9 | 19 |
| 3. Rumania | 9 | 13 |
| 4. Bjellorusia | 10 | 13 |
| 5. Shqipëria | 9 | 8 |
| 6. Luksemburgu | 10 | 4 |

**Nesër takohen**

| | | |
|---|---|---|
| 18:00 | Kazakistani | - Austria |
| 19:00 | Kroacia | - Letonia |
| 19:00 | Gjeorgjia | - Greqia |
| 19:00 | Gjermania | - Belgjika |
| 19:00 | Malta | - Izraeli |
| 19:00 | Turqia | - Azarbajxhani |
| 19:45 | Maqedonia | - SlLovakia |
| 19:45 | Irlanda | - Armenia |
| 19:45 | Rusia | - Andorra |
| 20:00 | Hungaria | - Finlanda |
| 20:00 | Moldavia | - San Marino |
| 20:00 | Suedia | - Holanda |
| 20:05 | Bullgaria | - Uellsi |
| 20:15 | Danimarka | - Portugalia |
| 20:15 | Norvegjia | - Qipro |
| 20:15 | Zvicra | - Mali i Zi |
| 20:45 | Italia | - Irlanda e V. |
| 20:45 | Lituania | - Çekia |
| 20:45 | Sllovenia | - Serbia |
| 20:45 | Spanja | - Skocia |
| 21:00 | Shqipëria | - Rumania |
| 21:00 | Franca | - Bosnje & H. |




Kaldaja
me Pilet
Prej: 25 kw
Deri: 950 kw
gorenje
Adresa: Veternik, 10 000 Prishtinë - Kosovë
info@gntc-ks.com www.gntc-ks.com
Mob: +386 49 77 77 55; Tel: +381 38 55 66 88;

